

**Marrëveshje**  
**ndërmjet**  
**Qeverisë Federale të Austrisë**  
**dhe**  
**Qeverisë së Republikës së Kosovës**  
**mbi**  
**ripranimin dhe transportimin transit të**  
**personave**  
**(Marrëveshja mbi Ripranimin)**

Qeveria Federale e Austrisë  
dhe  
Qeveria e Republikës së Kosovës

duke u nisur nga dëshira për të zhvilluar marrëdhënie miqësore dhe një bashkëpunim më të thellë midis të dy shteteve,

me synim t'i kundërvihet së bashku migracionit ilegal në frymën e përpjekjeve evropiane,

të udhëzuar nga dëshira për të rregulluar ripranimin e personave që qëndrojnë ilegalisht në territorin e palës tjetër kontraktuese, në përputhje me normat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe në frymën e bashkëpunimit besimplotë,

ranë dakord si më poshtë:

**Neni 1**  
**Ripranimi i shtetasve të vet**

(1) Çdo palë kontraktuese ripranon pa asnjë formalitet një person, i cili në territorin e palës kontraktuese kërkuese nuk plotëson ose nuk plotëson më kushtet që atje vlejnë për hyrjen ose qëndrimin, nëse dëshmohet ose bëhet e besueshme se ky person ka shtetësinë e palës kontraktuese të kërkuar.

(2) Paragrafi 1 vlen gjithashtu për personat, të cilët kanë humbur shtetësinë e palës kontraktuese të kërkuar pas hyrjes në territorin e palës kontraktuese kërkuese dhe nuk kanë fituar një shtetësi tjetër ose garancion natyralizimi nga ana e palës kontraktuese kërkuese.

(3) Pala kontraktuese e kërkuar ripranon me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese gjithashtu të gjithë fëmijët e mitur të pamartuar të personit ripranimi i të cilit kërkohet si edhe bashkëshortin/-ën e tij/saj, nëse ata kanë një shtetësi tjetër dhe nuk kanë të drejtë qëndrimi në territorin e palës kontraktuese kërkuese.

(4) Shtetësia mund të dëshmohet me anë të dokumenteve të përmendura në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje. Nëse prezantohet njëri prej këtyre dokumenteve, palët kontraktuese njohin shtetësinë pa qenë i nevojshëm një verifikim shtesë.

(5) Shtetësia mund të bëhet e besueshme me dokumentet e përmendura në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje. Nëse prezantohet njëri prej këtyre dokumenteve, palët kontraktuese konsiderojnë shtetësinë si të dokumentuar, nëse ato nuk mund të dëshmojnë të kundërtën.

(6) Nëse nuk mund të paraqitet asnjëri nga dokumentet e përmendura në shtojcën 1 ose 2, përfaqësitë diplomatike dhe konsullore kompetente të palës kontraktuese të kërkuar të përmendura në shtojcën 3 do të marrin masa me kërkesë të autoritetit kompetent të palës kontraktuese kërkuese për të marrë në pyetje personin që do të ripranohet brenda pesë ditëve të punës pas datës së kërkesës me qëllim që të konstatohet shtetësia e tij.

## Neni 2

(1) Nëse personi që do të ripranohet nuk ka dokument të vlefshëm udhëtimi, atëherë një kërkesë për ripranimin në bazë të formularit të përbashkët të shtojcës 6 i drejtohet autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar nga ana e autoritetit kompetent të palës kontraktuese kërkuese.

(2) Një kërkesë për ripranimin duhet të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- të dhëna në lidhje me personin që do të ripranohet (emrat, mbiemrat, datëlindjen dhe sipas mundësive emrin e babait, vendlindjen dhe vendqëndrimin e fundit);
- kopjet e dokumenteve që paraqesin dëshminë ose bërjen e besueshme të shtetësisë;
- një fotografi të personit në fjalë.

Sipas mundësive, kërkesa për ripranimin duhet të përmbajë edhe informacionet në vijim:

- një informacion për një nevojë eventuale të veçantë të personit që do të ripranohet për ndihmë, përkujdesje ose mbikëqyrje me miratimin e tij, nëse këto të dhëna janë të nevojshme për përkujdesjen mjekësore të personit në fjalë;
- sipas rastit, informacione të tjera për masat e nevojshme mbrojtëse ose sigurie me rastin e dorëzimit.

(3) Pala kontraktuese e kërkuar i përgjigjet një kërkesë për ripranim zakonisht brenda 14 ditëve kalendarike, por jo më vonë se brenda tridhjetë ditëve kalendarike. Afati fillon me pranimin e kërkesës për ripranim nga ana e autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar. Pas skadimit të këtij afati, miratimi për ripranimin do të konsiderohet si i dhënë.

(4) Pala kontraktuese e kërkuar lëshon – në rast nevoje – pa vonesë, por jo më vonë se brenda pesë ditëve të punës, dokumentet e udhëtimit të nevojshme për rikthimin e personit që do të ripranohet me një vlefshmëri prej tridhjetë ditëve dhe ia dërgon këto palës kontraktuese kërkuese.

(5) Nëse dorëzimi nuk është i mundshëm për shkak të pengesave juridike ose faktike gjatë kohëzgjatjes së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar, përfaqësia kompetente e palës kontraktuese të kërkuar në botën e jashtme do ta lëshojë brenda dhjetë ditëve të punës një dokument të ri udhëtimi, i cili do të jetë i vlefshëm për edhe tridhjetë ditë shtesë.

(6) Nëse pala kontraktuese e kërkuar është Republika e Kosovës dhe kjo nuk ka lëshuar dhe dërguar dokumentin e udhëtimit të përmendur në paragrafin 4 ose në paragrafin 5 të këtij neni brenda pesë ditëve të punës, atëherë do të konsiderohet se ajo do ta njohë dokumentin standard të udhëtimit të Bashkimit Evropian sipas përcaktimeve të rekomandimit të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 30 nëntor 1994.

(7) Autoriteti kompetent i palës kontraktuese kërkuese njofton autoritetin kompetent të palës kontraktuese të kërkuar për rikthimin e personit në fjalë zakonisht shtatë ditë

kalendarike para rikthimit të planifikuar, në raste të veçanta jo më vonë se tri ditë kalendarike.

(8) Nëse kërkesa për ripranimin refuzohet, refuzimi duhet të arsyetohet me shkrim.

### **Neni 3**

#### **Ripranimi i shtetasve të shteteve të treta dhe të personave pa shtetësi në rast të hyrjes së kundërligjshme dhe të qëndrimit të kundërligjshëm**

(1) Secila palë kontraktuese ripranon me kërkesën e palës kontraktuese tjetër një person, i cili nuk ka shtetësinë austriake ose kosovare, nëse ky person nuk plotëson ose nuk plotëson më kushtet e vlefshme për hyrje dhe qëndrim në territorin e palës kontraktuese kërkuese dhe mund të dëshkohet ose të bëhet e besueshme se ky person:

- ka ose ka pasur në momentin e hyrjes një vizë të vlefshme – me përjashtim të vizës për transitin në aeroport – ose një leje qëndrimi të vlefshëm të palës kontraktuese të kërkuar ose
- ka hyrë direkt në mënyrë të kundërligjshme në rrugë ajrore nga territori i palës kontraktuese të kërkuar në territorin e palës kontraktuese kërkuese ose
- ka hyrë me mashtrim nga territori i palës kontraktuese të kërkuar duke përdorur dokumente fallso ose të falsifikuara të palës kontraktuese të kërkuar ose
- ka pasur qëndrimin ligjor dhe vendbanimin e fundit në territorin e palës kontraktuese të kërkuar.

(2) Obligimi për ripranim i palës kontraktuese të kërkuar qëndron gjithashtu edhe në rastin kur të dyja palët kontraktuese kanë lëshuar një vizë ose një leje qëndrimi të cilës ndërkohë i ka skaduar afati, nëse afati i vizës ose i lejes të qëndrimit të lëshuar nga pala kontraktuese e kërkuar ka skaduar më vonë. Nëse afati skadon në të njëjtën ditë, ajo palë kontraktuese që ka lëshuar vizën ose lejen e qëndrimit me afatin më të gjatë të vlefshmërisë është e detyruar ta ripranojë personin.

(3) Pala kontraktuese kosovare ripranon me kërkesë të palës kontraktuese austriake një person me prejardhjen nga Kosova që nuk plotëson ose nuk plotëson më kushtet e vlefshme për hyrje ose qëndrim në territorin e palës kontraktuese austriake dhe që nuk ka fituar shtetësinë kosovare, nëse dokumentohet se ka pasur vendlindjen ose qëndrimin e zakonshëm në territorin e palës kontraktuese kosovare. Vendlindja ose vendqëndrimi i zakonshëm në Kosovë mund të dokumentohet me anë të dokumenteve publike të Ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, të Ish Republikës Federative të Jugosllavisë (nëse ato janë lëshuar para datës 10 qershor 1999), si dhe të fotokopjeve të tyre. Përveç kësaj, dëshmi mund të nxirret edhe nga dokumente tjera, vërtetime, fotokopje të tyre si dhe nga deklarata të dëshmitarëve dhe nga deklaratat e vetë personit në fjalë, që lënë të kuptohet se vendlindja ose vendqëndrimi i zakonshëm ka qenë në territorin e palës kontraktuese kosovare.

(4) Pala kontraktuese e kërkuar ripranon me kërkesë të palës kontraktuese kërkuese të gjithë fëmijët e mitur të pamartuar të personit ripranimi i të cilit kërkohet si dhe bashkëshortin/-ën e të njëjtit/-ës që ka një shtetësi tjetër, nëse këta nuk kanë të drejtë qëndrimi në territorin e palës kontraktuese kërkuese.

## Neni 4

(1) Hyrja direkte dhe qëndrimi i shtetasve të shteteve të treta dhe të personave pa shtetësi në territorin e palës kontraktuese kërkuese si dhe posedimi i një vize të vlefshme të lëshuar nga pala kontraktuese e kërkuar ose e një leje tjetër qëndrimi të vlefshme për territorin e palës kontraktuese të kërkuar mund të dëshmohet me anë të dokumenteve të përmendura në shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje. Një dëshmi e tillë do të njihet nga palët kontraktuese pa pasur nevojë të bëhet një verifikim shtesë.

(2) Hyrja direkte dhe qëndrimi i shtetasve të shteteve të treta dhe të personave pa shtetësi në territorin e palës kontraktuese kërkuese si dhe mbajtja e një vize të vlefshme të lëshuar nga pala kontraktuese e kërkuar ose e një leje tjetër qëndrimi të vlefshme për territorin e palës kontraktuese të kërkuar mund të bëhet e besueshme me anë të dokumenteve të përmendura në shtojcën 5 të kësaj Marrëveshjeje. Nëse prezantohet njëri prej këtyre dokumenteve, palët kontraktuese do të konsiderojnë këto fakte si të dëshmuara, nëse ato nuk mund të dëshmojnë të kundërtën.

(3) Kundërligjshmëria e hyrjes ose e qëndrimit konstatohet nëpërmjet mungesës së vizës së nevojshme ose të lejes së nevojshme të qëndrimit për territorin e palës kontraktuese kërkuese në dokumentet e udhëtimit të personit në fjalë. Deklarata e shtetit kërkues se personi në fjalë nuk ka dokumentet e nevojshme të udhëtimit, vizën e nevojshme ose lejen e nevojshme të qëndrimit paraqet gjithashtu një provë evidente për ilegalitetin e hyrjes ose të qëndrimit.

## Neni 5

(1) Nëse personi që do të ripranohet nuk posedon një dokument udhëtimi, një kërkesë për ripranimin në bazë të formularit të përbashkët të shtojcës 6 i drejtohet autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar nga ana e autoritetit kompetent të palës kontraktuese kërkuese.

Një kërkesë për ripranimin duhet të përmbajë informacionet në vijim:

- të dhënat në lidhje me personin që do të ripranohet (emrat, mbiemrat, datëlindja dhe sipas mundësive emrin e babait, vendlindjen dhe vendqëndrimin e fundit);
- kopjet e dokumenteve që paraqesin dëshminë ose bërjen e besueshme të shtetësisë;
- një fotografi të personit në fjalë.

Sipas mundësive, kërkesa për ripranimin duhet të përmbajë gjithashtu informacionet në vijim:

- një informacion për një nevojë eventuale të veçantë të personit që do të ripranohet për ndihmë, përkujdesje ose mbikëqyrje me miratimin e tij, nëse këto të dhëna janë të nevojshme për përkujdesjen mjekësore të personit në fjalë;
- sipas rastit, informacione të tjera për masat e nevojshme mbrojtëse ose sigurie në rast të dorëzimit.

(2) Pala kontraktuese e kërkuar i përgjigjet kërkesës për ripranimin pa vonesë, por jo më vonë se brenda dyzet e pesë ditëve kalendarike. Ky afat vlen edhe për rastet e parapara në nenin 3, paragrafi 3. Afati fillon me pranimin e kërkesës për ripranimin

nga ana e autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar. Pas skadimit të këtij afati miratimi për ripranimin do të konsiderohet si i dhënë.

(3) Pala kontraktuese e kërkuar lëshon – në rast nevoje – pa vonesë, por jo më vonë se brenda pesë ditëve të punës dokumentet e nevojshme të udhëtimit për rikthimin e personit që do të ripranohet me një vlefshmëri prej tridhjetë ditëve dhe ia dërgon këto palës kontraktuese kërkuese.

(4) Nëse dorëzimi nuk është i mundshëm për shkak të pengesave juridike ose faktike gjatë kohëzgjatjes së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar, përfaqësia kompetente e palës kontraktuese të kërkuar në botën e jashtme do të lëshojë brenda dhjetë ditëve të punës një dokument të ri udhëtimi, i cili do të jetë i vlefshëm për edhe tridhjetë ditë shtesë.

(5) Nëse pala kontraktuese e kërkuar është Republika e Kosovës dhe kjo nuk ka lëshuar dhe dërguar dokumentin e udhëtimit të përmendur në paragrafin 3 ose 4 brenda dhjetë ditëve të punës, atëherë do të konsiderohet se ajo do ta njohë dokumentin standard të udhëtimit të Bashkimit Evropian sipas përcaktimeve të rekomandimit të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 30 nëntor 1994.

(6) Dorëzimi i personit në fjalë bëhet pa vonesë, por jo më vonë se brenda një afati prej tre muajve, pasi që pala kontraktuese e kërkuar ta këtë dhënë miratimin për ripranimin. Ky afat do të zgjatet me kërkesë të palës kontraktuese kërkuese në rast të pengesave juridike ose faktike për dorëzimin.

(7) Nëse kërkesa për ripranimin refuzohet, refuzimi duhet të arsyetohet me shkrim.

## **Neni 6**

### **Modalitetet e rikthimit dhe lloji i transportimit**

(1) Para rikthimit të një personi, pala kontraktuese kërkuese njofton me shkrim autoritetin kompetent të palës kontraktuese të kërkuar për rikthimin e pritur duke e informuar për datën, pikën e kalimit të kufirit, shoqërues të mundshëm dhe informacione tjera, të cilat janë të rëndësishme për rikthimin.

(2) Transportimi bëhet në rrugë ajrore ose tokësore. Rikthimi në rrugën ajrore nuk kufizohet me përdorimin e shoqërive ajrore të palëve kontraktuese dhe mund të bëhet me fluturime të linjave dhe çartër.

## **Neni 7**

### **Ripranimi i gabuar**

(1) Në rastin e ripranimit të një shtetasi të një pale kontraktuese, të një shtetasi të një shteti të tretë ose të një personi pa shtetësi, pala kontraktuese kërkuese ripranon personin në fjalë pa asnjë formalitet, nëse pala kontraktuese e kërkuar brenda dy muajve pas ripranimit të këtij personi konstaton se kushtet për ripranimin nuk kanë qenë të dhëna.

(2) Në një rast të tillë vlejnë dispozitat procedurale përkatëse të kësaj Marrëveshjeje dhe të gjitha informacionet ekzistuese mbi identitetin dhe shtetësinë faktike si dhe dokumentet origjinale të personit që do të rikthehet duhet të transmetohen.

## **Neni 8** **Transportimi tranzit**

(1) Palët kontraktuese lejojnë transportimin tranzit të shtetasve të shteteve të treta dhe të personave pa shtetësi nëpër territorin e tyre, nëse pala tjetër kontraktuese kërkon këtë gjë dhe nëse vazhdimi i udhëtimit nëpër shtetet e mundshme të transitit deri në shtetin e destinacionit është i garantuar. Pala kontraktuese kërkuuese ia transmeton autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar një kërkesë me shkrim për transportimin transit sipas shtojcës 7 të kësaj Marrëveshjeje.

Kërkesa për transportimin transit duhet t'i parashtrohet me shkrim autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar dhe duhet të përmbajë informacionet në vijim:

- lloji i transportimit transit (në rrugë ajrore ose tokësore), shtetet e tjera transiti të mundshme dhe destinacioni i synuar;
- të dhënat e personit në fjalë (emri, mbiemri, datëlindja dhe – sipas mundësive – vendlindja, shtetësia, lloji dhe numri i dokumentit të udhëtimit);
- pika e parashikuar e kalimit të kufirit, koha e dorëzimit dhe shoqëruesit e mundshëm;
- një deklaratë sipas së cilës nga pikëpamja e palës kontraktuese kërkuuese janë plotësuar kushtet e parashikuara në nenin 8, paragrafi 1, dhe nuk njihen arsye për një refuzim sipas nenit 8, paragrafi 2.

(2) Transportimi transit mund të refuzohet, nëse

- personi kërcënohet në një shtet tjetër transiti ose në shtetin e destinacionit me torturë, një trajtim apo dënim çnjerëzor ose poshtëruës ose dënim me vdekje ose një përndjekje për shkak të racës, fesë, shtetësisë, përkatësisë së një grupi të caktuar social ose të bindjeve politike të tij;
- personi kërcënohet në territorin e palës kontraktuese të kërkuar me një përndjekje penale ose ekzekutimin e një dënimi;
- cenohet shëndeti, rendi ose siguria publike e palës kontraktuese të kërkuar.

(3) Autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar e njofton me shkrim palën kontraktuese kërkuuese brenda pesë ditëve të punës lidhur me dorëzimin, duke konfirmuar pikën e kalimit të kufirit dhe kohën e parashikuar për dorëzimin ose duke bërë të ditur arsyet e refuzimit të dorëzimit.

(4) Pala kontraktuese e kërkuar mund të anulojë një miratim tanimë të dhënë për transportimin transit, nëse më vonë dalin në pah ose bëhen të ditura fakte si ato të parashikuara në paragrafin 2 që i kundërvihen transportimit transit ose nëse vazhdimi i udhëtimit për në shtetet transit të mundshme ose ripranimi në shtetin e destinacionit nuk është më i garantuar. Në këtë rast, pala kontraktuese kërkuuese e rikthen menjëherë personin në fjalë, nëse ky u ripranua përpara nga pala kontraktuese e kërkuar për transportimin transit.

(5) Nëse transportimi transit bëhet në rrugë ajrore, personi që do të ripranohet dhe shoqëruesit e mundshëm janë të liruar nga kërkesa për një vizë transiti për aeroport.

## **Neni 9 Shpenzimet**

(1) Të gjitha shpenzimet në lidhje me rikthimin deri në kufirin e territorit të palës kontraktuese të kërkuar, më tej shpenzimet e transportimit transit sipas nenit 8, do të barten nga pala kontraktuese kërkuese.

(2) Në rast të një ripranimi të gabuar sipas nenit 7 së bashku me nenet 1, 3 dhe 8, pala kontraktuese kërkuese do t'i bartë edhe shpenzimet e nevojshme për kthimin mbrapsht.

## **Neni 10 Mbrojtja e të dhënave**

(1) Përdorimi i të dhënave personale do të ndodhë vetëm nëse përdorimi është i nevojshëm në rastin konkret për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga ana e autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese. Nëse është e nevojshme të transmetohen të dhëna personale për zbatimin e kësaj marrëveshjeje për rikthimin e personit në fjalë në shtetin tjetër kontraktues, këto informacione duhet të përfshijnë vetëm:

1. të dhënat personale të personit që do të dorëzohet dhe në rast nevojë ato të anëtarëve të familjes (mbiemri, emri, emri i mëparshëm, nëse ka pasur më përpara një emër tjetër, emrat shtesë ose pseudonime, datëlindjen dhe vendlindjen, seksin, shtetësinë e tanishme dhe atë të mëparshme);
2. dokumentet e identitetit (lloji i dokumentit, numri, afati i vlefshmërisë, data e lëshimit, autoriteti i lëshimit, vendi i lëshimit);
3. të dhëna të tjera për identifikimin e personit që do të dorëzohet, do të transmetohen në qoftë se është e nevojshme dhe ligjërisht e mundshme;
4. vendet e qëndrimit dhe itineraret e udhëtimit;
5. të dhëna të tjera me kërkesë të një pale kontraktuese që ka nevojë për to për verifikimin e kushteve për ripranimin sipas kësaj Marrëveshjeje, do të transmetohen në qoftë se është e nevojshme dhe ligjërisht e mundshme;

(2) Nëse në kuadër të kësaj Marrëveshjeje përdoren të dhëna personale, përveç legjislacionit kombëtar të secilës palë kontraktuese vlejné edhe parimet në vijim:

1. Përdorimi i të dhënave nga ana e marrësit lejohet vetëm për qëllimin e përmendur dhe në kushtet e përcaktuara nga autoriteti transmetues.
2. Marrësi informon autoritetin transmetues me kërkesën e tij mbi përdorimin e të dhënave të transmetuara dhe mbi rezultatet e arritura në këtë mënyrë.



3. Të dhënat personale lejohet t'u transmetohen vetëm sektorëve kompetentë. Autoriteti kompetent garanton se vetëm persona të autorizuar do të kenë qasje në të dhënat e transmetuara. Transmetimi i mëtejshëm në sektorë të tjerë lejohet vetëm pas miratimit paraprak nga ana e sektorit transmetues.

4. Autoriteti transmetues është i detyruar të kujdeset për saktësinë e të dhënave që do të transmetohen si dhe për nevojën dhe proporcionalitetin në lidhje me qëllimin e synuar me transmetimin. Në këtë rast duhet të respektohen ndalimet e transmetimit sipas legjislacionit të brendshëm të secilit shtet. Nëse rezulton se u transmetuan të dhëna të pasakta, ose të dhëna që nuk duhej të hetoheshin ose të transmetoheshin, ose fakti se të dhënat nuk janë më të nevojshme për plotësimin e detyrës së autoritetit për të cilën janë transmetuar, marrësi duhet të informohet menjëherë për këtë. Ai është i detyruar të bëjë korrigjimin ose fshirjen e këtyre të dhënave.

5. Autoriteti transmetues si edhe autoriteti marrës janë të detyruar të shënojnë në dosjet e tyre transmetimin dhe marrjen e të dhënave personale, të mbajnë shënime për qëllimin, kohën dhe përmbajtjen e të dhënave të marra ose të transmetuara sipas legjislacionit në fuqi të secilit shtet. Të dhënat e protokollit duhet të ruhen të paktën dy vjet dhe lejohen të përdoren vetëm për kontrollin e respektimit të rregullave përkatëse të mbrojtjes së të dhënave sipas legjislacionit në fuqi të secilit shtet.

6. Autoriteti transmetues si edhe autoriteti marrës janë të detyruar t'i mbrojnë të dhënat personale në mënyrë efikase kundër qasjes së paautorizuar, ndryshimit të paautorizuar dhe publikimit të paautorizuar.

## **Neni 11** **Zbatimi i marrëveshjes**

(1) Hollësitë e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të rregullohen midis palëve kontraktuese në kuadër të një protokollit të zbatimit.

(2) Palët kontraktuese angazhohen t'i zgjidhin problemet që mund të rrjedhin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje me mirëkuptim. Secila palë kontraktuese mund të kërkojë në rast nevoje bisedime ekspertësh mbi çështjet e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

## **Neni 12** **Klauzola e pa-prekshmërisë**

(1) Të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që dalin, direkt apo indirekt, nga Ligjet Kombëtare apo Konventat Ndërkombëtare, dhe në veçanti, nga:

- Zbatimi i Marrëveshjes mbi Statusin Ligjor të Refugjatëve (Konventa e Gjenevës për Refugjatë) e datës 28 korrik 1951 së bashku me Protokollin e Nju Jorkut mbi Statusin Ligjor të Refugjatëve e datës 31 janar 1967,
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e datës 4 nëntor 1950 bashkë me protokollet e saj shtesë,

- Konventa për mbrojtjen e njeriut në rast të përpunimit të automatizuar të të dhënave personale e datës 28 janar 1981 në versionin e protokollit shtesë të saj të datës 8 nëntor 2001,
- Konventën e datës 10 Dhjetor 1984 kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera të tmerrshme, çnjerëzore apo poshtëruese, si dhe
- Konventa për të drejtat e fëmijëve e datës 20 nëntor 1989.

mbeten të paprekura nga kjo Marrëveshje.

(2) Detyrimet e Republikës së Austrisë që dalin nga anëtarësia e saj në Bashkimin Evropian mbeten të paprekura.

### **Neni 13** **Dispozitat përfundimtare**

(1) Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajt të dytë pas ditës në të cilën palët kontraktuese do të kenë informuar njëra-tjetrën në rrugë diplomatike për përfundimin e procedurave të tyre kombëtare për hyrjen në fuqi.

(2) Kjo Marrëveshje lidhet për një kohë të pacaktuar.

(3) Çdo palë kontraktuese mund të propozojë ndryshime të kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja do të ndryshohet ose do të plotësohet me pëlqim reciprok me shkrim nëpërmjet një protokollit ndryshues. Protokollit ndryshues do të hyjë në fuqi sipas paragrafit 1.

(4) Çdo palë kontraktuese ka mundësi ta pezullojë plotësisht ose pjesërisht zbatimin e Marrëveshjes për arsye të sigurisë, të rendit ose të shëndetit publik. Pezullimi, që duhet të bëhet në rrugë diplomatike, hyn në fuqi në ditën e dytë pas pranimit të njoftimit nga pala tjetër kontraktuese.

(5) Çdo palë kontraktuese mund ta ndërprej me shkrim këtë Marrëveshje në rrugë diplomatike. Në këtë rast Marrëveshja shfuqizohet gjashtë muaj pas pranimit të njoftimit për ndërprerje nga pala tjetër kontraktuese.

## **Neni 14**

Regjistrimi i kësaj Marrëveshjeje te Sekretariati i Kombeve të Bashkuara sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara do të organizohet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi nga Qeveria e Federale e Austrisë.

E bërë në Vjenë më 30.09.2010 në dy origjinal, secili në gjuhën gjermane, shqipe dhe serbe, secili version me fuqi të njëjtë detyruese.

Për Qeverinë Federale  
të Austrisë

Maria Fekter m.p.

Për Qeverinë e  
Republikës së Kosovës

Bajram Rexhepi m.p.

**Shtojca 1**Lista e përbashkët e dokumenteve që do të konsiderohen si dëshmi e shtetësisë (neni 1, paragrafi 4)

- çdo lloj pasaporte (pasaportat e udhëtimit, pasaportat diplomatike dhe pasaportat zyrtare);
- letërnjoftimi;
- dokumentet e marinarëve dhe dokumentet e kapitenëve;
- dëshmia e shtetësisë;
- dokumenti i Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK);

**Shtojca 2**Lista e përbashkët e dokumenteve që do të konsiderohen si mundësi për bërjen e besueshme të shtetësisë (neni 1, paragrafi 5)

- kopjet e dëshmimeve të përmendura në shtojcën 1 të kësaj marrëveshjeje;
- certifikata e lindjes dhe kopja e saj;
- patentat dhe kopja e saj;
- dokument udhëtimi i lëshuar nga UNMIK-u dhe letërnjoftim i lëshuar nga UNMIK-u si dhe kopjet e tyre;
- dokumente të tjera që mund të ndihmojnë për përcaktimin e shtetësisë;
- deklaratat të dhëna nga dëshmitarë;
- deklaratat e vetë personit dhe gjuha e të interesuarit;
- rezultati i marrjes në pyetje të të interesuarit nga ana e sektorëve kompetentë të palës kontraktuese të kërkuar që do të realizohet me kërkesë të palës kontraktuese kërkuuese;
- konfirmimi i identitetit si rezultat i kërkimit në sistemin informativ të vizave;<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Rregullorja (BE) nr. 767/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 korrik 2008 mbi sistemin informatik të vizave dhe shkëmbimin e të dhënave midis shteteve anëtare mbi vizat për një qëndrim afatshkurtër (Rregullorja mbi Sistemin Informatik të Vizave), Gazeta Zyrtare e BE-së nr. L 218 e datës 13.8.2008, f. 60.

### **Shtojca 3**

Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore kompetente për realizimin e intervistës me qëllim të konstatimit të shtetësisë sipas nenit 1, paragrafi 6, të kësaj marrëveshjeje janë

- Nga ana kosovare

Ambasada e Republikës së Kosovës në Vjenë

- Nga ana austriake

Ambasada e Republikës së Austrisë në Prishtinë

Palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën për të dhënat kontaktuese në rrugë diplomatike në lidhje me autoritetet kompetente të përmendura në këtë shtojcë.

**Shtojca 4**

Lista e përbashkët e dokumenteve që do të konsiderohen si dëshmi e plotësimit të kushteve për ripranimin e shtetasve të shteteve të treta dhe të personave pa shtetësi (neni 4, paragrafi 1)

- vula e daljes dhe e hyrjes e autoriteteve të palës kontraktuese të kërkuar në dokumentet e udhëtimit;
- një dokument i vlefshëm, p. sh. vizë dhe/ose leje qëndrimi që është lëshuar nga shteti i kërkuar për qëndrimin e ligjshëm në territorin e shtetit të kërkuar;
- bileta e aeroplanit, biletat e trenit ose të autobusit, dokumente të pajisura me emrin dhe mbiemrin, çdo lloj vërtetimi ose fature nga të cilat del qëndrimi ose itinerari i udhëtimit i personit në fjalë në territorin e palës kontraktuese të kërkuar;

**Shtojca 5**

Lista e përbashkët e dokumenteve që do të konsiderohen si mundësi për bërjen e besueshme të plotësimit të kushteve për ripranimin e shtetasve të shteteve të treta dhe të personave pa shtetësi (neni 4, paragrafi 2)

- vendi dhe rrethanat në të cilat personi në fjalë është kapur pas hyrjes;
- deklaratat e anëtarëve të autoriteteve kufitare që mund të dëshmojnë kalimin e kufirit;
- informacionet e marra nga një organizatë ndërkombëtare mbi identitetin ose qëndrimin e personit në fjalë;
- deklaratat e dhëna nga dëshmitarë;
- deklaratat e personit në fjalë;
- shënime të tjera të autoriteteve të palës kontraktuese të kërkuar në dokumentet e udhëtimit;
- konfirmimi i identitetit si rezultat i kërkimit në sistemin informativ të vizave.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> RRegullorja (BE) nr. 767/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nga data 9 korrik 2008 mbi sistemin informatik të vizave dhe shkëmbimin e të dhënave midis shteteve anëtare mbi vizat për një qëndrim afatshkurtër (RRegullorja mbi Sistemin Informatik të Vizave), Gazeta Zyrtare e BE-së nr. L 218 nga data 13.8.2008, f. 60.

**Shtojca 6**

[Emblema e Republikës së Austrisë]

[Emblema e Republikës së Kosovës]

.....  
 .....  
 .....  
 .....  
 .....  
 .....

.....  
 (Emri i autoritetit kërkues)

.....  
 .....

(Vendi dhe data)

Numri i dosjes: .....

Marrësi:

.....  
 .....  
 .....  
 .....  
 .....  
 .....

.....  
 (Emri i autoritetit të kërkuar)

o KËRKESË PËR MARRJEN NË PYETJE (neni 1, paragrafi 6)

**KËRKESË PËR RIPRANIMIN**

o sipas nenit 1 (shtetas të vetë)

o sipas nenit 3 (shtetas të shteteve të treta ose persona pa shtetësi)

të marrëveshjes nga data ..... midis Qeverisë Federale të Austrisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi ripranimin dhe transportimin transit të personave (Marrëveshja e Ripranimit)

**A. TË DHËNAT NË LIDHJE ME PERSONIN**

1. Emri i plotë (mbiemri nënvizohet):


.....  
.....

2. Mbiemri në momentin e lindjes:

.....  
.....

3. Datëlindja dhe vendlindja:

.....  
.....



4. Gjinia dhe përshkrimi i personit (gjatësia e trupit, ngjyra e syve, shenja të veçanta etj.):

.....  
.....

5. Emra të tjerë (emra të mëparshëm, emrat e tjerë që përdoren / me të cilët personi njihet):

.....  
.....

6. Shtetësia dhe gjuha:

.....  
.....

7. Gjendja civile:  i/e martuar  i/e pamartuar  i/e ndarë  i/e ve

Nëse personi është i martuar, emri i bashkëshortit / i bashkëshortes:

.....

Sipas rastit emrat dhe mosha e fëmijëve:

.....  
.....  
.....  
.....

8. Adresa e fundit në territorin e palës kontraktuese kërkuese:



.....  
.....

**B. TË DHËNAT NË LIDHJE ME BASHKËSHORTIN/-ËN (NËSE KA)**

1. Emri i plotë (mbiemri nënvizohet):

.....  
.....

2. Mbiemri në momentin e lindjes:

.....  
.....

3 . Datëlindja dhe vendlindja:

.....  
.....

4. Gjinia dhe përshkrimi i personit (gjatësia e trupit, ngjyra e syve, shenjat e veçanta etj.):

.....  
.....

5. Emra të tjerë (emra të mëparshëm, emra të tjerë që përdoren / me të cilët personi njihet):

.....  
.....

6. Shtetësia dhe gjuha:

.....  
.....

**C. TË DHËNAT E FËMIJËVE (NËSE KA)**

1. Emri i plotë (mbiemri nënvizohet):

.....  
.....

2. Datëlindja dhe vendlindja:

.....  
.....

3. Gjinia dhe përshkrimi i personit (gjatësia e trupit, ngjyra e syve, shenja të veçanta etj.):

.....  
 .....

4. Shtetësia dhe gjuha:

.....  
 .....

#### D. INFORMACIONE TË VEÇANTA NË LIDHJE ME PERSONIN QË DO TË RIKTHEHET

1. Gjendja shëndetësore

(p. sh. një informacion mbi një përkujdesje të veçantë mjekësore; emri i një sëmundjeje ngjitëse në gjuhën latine):

.....  
 .....

2. Informacion mbi rrezikshmërinë e veçantë të personit

(p. sh. dyshimi i një vepre penale të rëndë; sjellje agresive):

.....  
 .....

#### E. DËSHMITË E BASHKANGJITURA

1. ....

.....

(Nr. i pasaportës)

(Data dhe vendi i lëshimit)

.....

.....

(Autoriteti që e ka lëshuar)

(Skadimi i vlefshmërisë)

2. ....

.....

(Nr. i letërnjoftimit)

(Data dhe vendi i lëshimit)

.....

.....

(Autoriteti që e ka lëshuar)

(Skadimi i vlefshmërisë)

3. ....	.....
.....	.....
(Nr. i patentës)	(Data dhe vendi i lëshimit)
.....	.....
.....	.....
(Autoriteti që e ka lëshuar)	(Skadimi i vlefshmërisë)
4. ....	.....
.....	.....
(Nr. i dokumentit tjetër zyrtar)	(Data dhe vendi i lëshimit)
.....	.....
.....	.....
(Autoriteti që e ka lëshuar)	(Skadimi i vlefshmërisë)

#### F. REALIZIMI I MARRJES NË PYETJE SIPAS NENIT 1, PARAGRAFI 6

- Pasi që nuk ka mundësi të bashkëngjiten dokumentet e përmendura në shtojcën 1 ose 2 (shtetasit e vetë) të Marrëveshjes mbi Ripanimin, kërkohet realizimi i marrjes në pyetje me qëllim të konstatimit të shtetësisë.
- Ne rast të dyshimeve të autenticitetit të dokumenteve të bashkëngjitura kërkohet realizimi i marrjes në pyetje me qëllim të konstatimit të shtetësisë.

#### G. VËREJTJE

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

(Nënshkrimi) (Vula)

**Shtojca 7**

[Emblema e Republikës së Austrisë]

[Emblema e Republikës së Kosovës]

.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....

.....  
.....

.....  
(Emri i autoritetit kërkues)

(Vendi dhe data)

Numri i dosjes: .....

Marrësi

.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....

.....  
(Emri i autoritetit të kërkuar)


**KËRKESE PËR TRANSPORTIMIN TRANZIT**

sipas nenit 8 të Marrëveshjes midis Qeverisë Federale të Austrisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi ripranimin dhe transportimin transit të personave (Marrëveshja mbi Ripranimin) të datës .....

**A. TË DHËNAT NË LIDHJE ME PERSONIN**

1. Emri i plotë (mbiemri nënvizohet):

.....




2. Mbiemri në momentin e lindjes:

.....

3. Datëlindja dhe vendlindja:

.....



4. Gjinia dhe përshkrimi i personit (gjatësia e trupit, ngjyra e syve, shenjat e veçanta etj.):

.....

.....

5. Emra të tjerë (emra të mëparshëm, emra të tjerë që përdoren / me të cilët personi njihet):

.....

.....

6. Shtetësia dhe gjuha:

.....

.....

7. Lloji dhe numri i dokumentit të udhëtimit:

.....

.....

## B. NË RAST NEVOJE INFORMACIONE TË VEÇANTA NË LIDHJE ME PERSONIN QË DO TË RIKTHEHET

1. Gjendja shëndetësore

(p. sh. një informacion mbi një përkujdesje të veçantë mjekësore; emri i një sëmundjeje ngjitëse në gjuhën latine):

.....

.....

2. Informacion mbi rrezikshmërinë e veçantë të personit

(p. sh. dyshimi i një vepre penale të rëndë; sjellje agresive):

.....

.....

## C. TRANSPORTIMI TRANZIT

1. Lloji i transportimit transit:  
 në rrugë ajrore       në rrugë tokësore

2. Shteti i destinacionit:

.....  
.....

3. Nëse ka, shtete të tjera transiti:

.....  
.....

4. Pika e kalimit të kufirit e parashikuar, data dhe ora e rikthimit dhe nëse ka personat shoqërues:

.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....

5. A është ripranimi i garantuar në shtetet e tjera të mundshme të transitit dhe në shtetin e destinacionit?

(neni 8, paragrafi 1)

- Po       Jo

6. A njihen arsye për refuzimin e transportimit transit? (neni 8, paragrafi 2)

- Po       Jo

**D. VËREJTJE**

.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....

.....  
(Nënshkrimi) (Vula)